



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 10832 PRO/6

Vlorë, më: 28. 09 2022

DËGJESË PUBLIKE

Mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe planifikimi për Projekt Buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë Vlorë

RAJONI 5

Data 21.09.2022: ora 13.00

Pjesëmarrës: Nënkyetarja e Bashkisë Vlorë, Drejtore të administratës dhe Institucionit të Bashkisë Vlorë, banorë dhe biznesmenë. (listëprezenca bashkangjitur).

Brisilda Çobaj-Kryetare e Rajonit 3: Ju falenderoj për prezencën. Jemi mbledhur për të diskutuar mbi projekt buxhetin e vitit 2023 dhe programin afatmesem 2023-2025 për bashkinë Vlorë.

Në rajonin tonë janë bërë investime në ndricim, infrastrukturë, pastrim etj por duhen bërë akoma. Kërkesat do ti mbajnë shënim për tu parashkuar dhe vlerësuar për buxhetin 2023.

Daut Zeraj: Jemi mbledhur për të diskutuar mbi programin afatmesëm 2023-2025 dhe projekt buxhetin 2023. Parashikohet një ngritje graduale e buxhetit..

Për vitin 2022 të parashikuar për buxhetim kanë qënë rrëth 2 milion.

Për vitin 2023 parashikohet një rritje rrëth 5%. Në këtë buxhet i është kushtuar rëndësi fondit për shërbimet në infrastrukturë. Është planifikuar dhe i është dhënë rëndësi si në PBA dhe në projekt buxhetin e vitit 2023, rikonstrukcionit të shkollave dhe kopshteve.

Përparësi kryesisht i është dhënë pastrimit, janë parashikuar fonde për pastrimin e qytetit.

Vitin e ardhshëm do të vihet në punë Landfilli. Është parashikuar si prioritet Fusha e Aviacionit.

Këto janë pak a shumë të dhënat për shërbimet në komunitet. Cdo rritje në buxhet, synon në rritjen e fondit të investimeve, pastrimit, rikonstrukcionit të shkollave, jo rritje të numrit të punonjësve dhe rritje të pagës.

Nga ana juaj kérkojmë, problematikat më emergjente, ato që mund tē bëhen me fondin e bashkisë por edhe pér bashkëfinancime. Presim tē dëgjojmë problematikat tuaja.

Qytetar -Banor i L. Kushtrimi- bëni mirë që vini dhe mblidhemi pér problemet tona. Rruga “Bektash Cakrani” rrëth 120m e prishur. Në kohen e pandemisë erdhi skrepi...tek tyneli, parnë paraburgimit, nuk pastrohet.

Qytetar - jemi mbledhur pér projekt buxhetin. Ndricimi është zgjidhur.

Daut Zeraj: Edhe trotuari...

Qytetar : Projektet janë bërë disa herë. Blloku ynë është shumë keq, rrugët e brendshme. Janë në gjendje të keqe.

Qytetar : Banor tek blloku “Jalli i Nartës”, mungojnë kanalizimet. S’janë pastruar pusetat. Mungojnë llambat pér ndricim. Mungon kazani i mbeturinave.

Qytetar : Banore e Lgj. Lirim-Faleminderit që na mblidhni dhe bëjmë takime tē tilla, falenderoj dhe bashkinë pér punën e mirë. Por është shumë problem, kemi një pjesë rruge, rrëth 10 m me gropë.

Qytetar -Banor te Fusha e Aviacionit-Kanali nga Fusha e Aviacionit , bashkohet tek burgu, është lënë pa pastruar. Kam kontaktuar, është shumë problem.

Brisilda Cobaj: Kérkesa juaj është depozituar pranë Ndërmarrjes së Ujësjellësit.

Qytetar : Problem është therrorja. Nga KASTRATI deri tek kupola e Aviacionit është çarë rruga. Mbulluar me ferra, tē pastrohet. Problem tjetër me komshiun. Shtylla e tensionit, 10 m nga larg nga shtëpia. I takon OSHEE.

Brisilda Cobaj: edhe unë e kam bërë kérkesën pranë OSHEE me firmën e kryetarit tē bashkisë.

Qytetar : Më vjen mirë që rajoni me bashkinë organizon këto dëgjesa, që ne tē bëjmë prezente problematikat tona. Do tē them ato që janë bërë në fillim.

“ 28 Nëtori” tek ish frogoriferi. Nuk mungon uji i pijshëm. Është bërë disiplinimi i KUZ. Ndriçimi rrugor është bërë. Infrastruktura është ngritur si problem që në buxhetin e vitit 2011. Pra problem infrastruktura.

Rrugët në lagjen “28 Nëntori”. Kanali rrëth 7 m tek ura. Duhen 7 tuba, nuk është ndonjë shpenzim. Duhet edhe një skrep. Këto kisha faleminderit.

Qytetar : Banor I lagjes “ Lirim” – rruga është problem. Problem te banesa e vet. Komshiu ka bërë shtesë. Banon sipër tij, ka pemë, është shumë keq.

Brisilda Cobaj: Komshiu ka shtesën në eproces legalizimi, duhet tē presim nga institucione tē tjera.

Qytetar : Kam kohë me këtë problem, s’kam gjetur zgjidhje.

Aulona Veizi-nen kryetare e Bashkisë Vlore- Sillni dokumentacionin dhe e diskutojmë. Pse nuk I krasit pemët ai? Hajdeni bashkë me kryetaren e rajonit në bashki dhe të shkojmë në drejtoritë përkatëse. Këtu nuk zgjidhet. Sillni dokumentacionin dhe flasim.

Qytetar : Banor i Lgj. Kushtrimi- Vlora ëshët kthyer në kantier ndërtimi. Është punuar. Jemi të kënaqur me pastrimin, po punohet. Kërkesa jonë janë problem I ujrave të zeza, di se janë disiplinuar. Të shkojmë në mbrëmje te shtëpia e zotërisë që është pranë Drejtorisë së Paraburgimit. Ai është KUB. A shkojmë dot te zotëria? Te kanali ka shumë ndotje. Rreth 300 m mungon ndriçimi. Te hangarët. Te tynëlet kalojnë qytetarët. Mungon ndricimi.

Faleminderit që na keni mbledhur...rruga te ura, a ka ndonjë projekt?

Daut Zeraj: është rruge dhe bllokohet nga....

Qytetar : Jo

Qytetar : Flas me respekt për zonjën kryetare, punon. Rajoni ynë është me probleme. Që nga rotundo deri te Fusha e Avacionit, të shihet rruga, ndricimi.

Te kupola e avacionit, është pastruar kanali dhe janë mbetjet akoma jashtë. Të vijë skrepitë heqë.

Daut Zeraj: ne jemi zonë informale. Kjo zonë do një projekt pilot, ne smundemi. Kemi projekt, e kemi cuar në qeveri. Do shumë fonde.

Qytetar : A ëshët kompetencë e rajonit, ku është prishur rruga nga puna e ujësjellësit, hapin gropat...është emergjente rruga "Haxhi Xhyheri" është problematike. Ka këmpetenca kryetare e rajonit, që nesër që të vijë qytetari ajo ta rregullojë?

Daut Zeraj: Këto janë të riparueshme, investime të vogla do bëhen.

Qytetar : Rruga nga rotundo deri te fusha e Avacionit, është e zënë.

Qerem Llapani: biznes- Jam ndërtues. Kisha një pyetje. Kur fillojnë ndërtimet për lagjen "Kushtrimi"? Është problem infrastruktura. Kur do filloj?

Daut Zeraj: Na u kërkua nga FSHZH dhe kemi dhënë lagjen Kushtrimi. Cfarë do realizohet?

Qytetar : Lulishtet janë të thara, pemët pa krasitur.

Erinolda Lushaj: Drejtore NSHP- Pemët krasiten në fund të muajit tetor.

Qytetar : Kam marrë pjesë në mbledhje të tillë. Problem I lagjes Kushtrimi. KUZ kur ka një paln të pastrohen? Problem, shkon uji I pijshëm kot. Disa kanë, disa jo, të shtohen kontrolllet.

Qytetar : KUZ nga Kastrati – drejtoria e Paraburgimit, është problem, duhet pastruar urgjent. Nuk kalon dot te ura. Është urgjente.

Qytetar : Problem ndriçimi, mungojnë llambat.

Brisilda Cobaj: Ju falenderoj për pjesëmarjen, dhe ju premtoj se do ti shohim me përparësi.

Hartoi

Albana Naçi

Koordinatore për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Bashkia Vlorë



